

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALBTRIX” Shpk

Neni 1

Emri i Shoqërise është : “ALBTRIX” Shpk

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Durrës, Rruga Plazh/13, Hyrja 4, Apartamenti 10.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.

Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpëra këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë është aktiviteti i zhvillimit të software-ve aplikative, aktiviteti i konsulencës në fushën e software-ve aplikative, aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë, software si shërbim, aktivitet në shërbime të adoptimit dhe përshtatjes së software-ve, aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhenave përkatëse, teknologja informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike, publikimi i software-ve, aktivitet i këshillimeve kompjuterike.

Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.

Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me, shit-blerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultat i, apo që ka lidhje me objektin e saj.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali është i përbërë nga 2 kuota kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara.

Kuotat e Kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

- a) Skender Aliu, lindur më 29/10/1979 në Tupallë, Kosovë, mbajtës I nr.personal 1011015413, zotërues i një kuote me vlerë të per gjithshme 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, që përben 60% të kapitalit të Shoqërisë
- b) Festim Krasniqi, lindur më 05/05/1989 në Prishtinë, Kosovë, mbajtës I nr.personal 1175316945, zotërues i një kuote me vlerë të per gjithshme 40,000 (dyzetë mijë) lekë, që përben 40% të kapitalit të Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria administrohet nga administratori. Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Nëpërmjet këtij akti, emërohet Administrator z. Skender Aliu, i lindur më 29/10/1979 në Tupallë, Kosovë, mbajtës i nr. Personal: 1011015413, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori ka të drejtë të veprojë, personalisht ose duke i deleguar personave të tretë, lidhur me të, të gjitha procedurat për regjistrimin e Shoqërisë si person juridik pranë organit kompetent. Ai është i autorizuar të veprojë për llogari të Shoqërisë deri sa regjistrimi i saj të ketë përfunduar.

Administratorit të sipërpërmëndur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitlja akteve në emër dhe për llogari të Shoqerise dhe ai mund të delegojë pushtetin e tij tek persona të tretë, me prokura të posaçme të noterizuara.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë marrëvephje apo Shoqërinë, do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Lexuar, nënshkruar

ORTAKET
Shoqëria "ALBTRIX" Shpk

Z.SKENDER ALIU

Z. FESTIM KRASNIQI

DT: 18.01.2021